




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
 Dep. DPK
 Nr. i faq. _____
 Broj stranica 02
 Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
 Br. Prot. 03-02/2322/17
 Prot No. _____
 Data _____
 Datum 04-09-2017
 Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 04.09.2017, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-1482/17, për zyrtarin e lartë z. Shyqeri Gashi, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-1482/17, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Shyqeri Gashi, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës.

Informatën për rastin në fjalë e kemi pranuar nga një palë e tretë, ku është kërkuar nga AKK-ë si institucion kompetent që të shqyrton rastin me dyshimin për konflikt të interesit.

Gjatë zhvillimit të procedurës lidhur me rastin në fjalë janë ndërmarrë veprime konkrete të parapara për parandalimin e konfliktit të interesit apo konstatimin për mos pajtueshmëri në ushtrim të funksionit publik.

Nga informatat dhe dokumentacionit që kemi pasur në dispozicion lidhur me rastin në fjalë kemi vërejtur se zyrtari i lartë z. Shyqeri Gashi, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, figuron si person i autorizuar në një biznese private e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr. 04/L-051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia



kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese zyrtari i lartë z. Shyqeri Gashi, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, ka ardhur në takim dhe nga zyrtarët e AKK-së, është njoftuar me çështjen e iniciuar për konflikt të interesit si dhe obligimet që ka pasur ai lidhur me transferimin e të drejtave në drejtim të Ndërmarrjes apo biznesit ku figuron si pronar dhe person i autorizuar.

z.Gashi, gjatë këtij takimi është pajtuar me faktet e prezantuara nga AKK dhe ka deklaruar se biznesi në fjalë ku figuron si pronar dhe person i autorizuar nuk zhvillon aktivitet që nga punësimi i tij në Administratën Tatimore të Kosovës por ka mbet vetëm i regjistruar, mos mbyllja e këtij biznesi ka qen si pasojë e harresës dhe neglizhencës dhe ska pa asnjë qellim tjetër, gjatë këtij takimi z.Gashi ka deklaruar se do të marr të gjitha veprimet dhe në afatin sa me të shpejt do ta mbyllë këtë biznes që të shmanget nga situata e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik, edhe pse ky biznes nuk zhvillon veprimtari.

Pas këtij takimi z.Gashi, ka ndërmarr veprimet e nevojshme duke sjell në Agjenci dëshmi lidhur me mbylljen apo shuarjen vullnetare të biznesit me emër ZYRE PER SHERBIME PROFESIONALE "EURO AUDIT".

Duke vlerësuar veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, z. Shyqeri Gashi, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës, duke e mbyllur biznesin në fjalë si dhe duke pas parasysh se biznesi në fjalë nuk ka zhvilluar aktivitet apo veprimtari biznesore, konsiderojmë se janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendja e mundshme e konfliktit të interesit dhe mos pajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Shyqeri Gashi, Inspektor Tatimor në Administratën Tatimore të Kosovës sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051,dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Shaip Havolli

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

